



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 25 Shkurt 2022

Nr: 23

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS PËR KOMISIONET E ZONAVE TË  
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR  
ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS,  
VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË DATË 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13 438, datë 20.1.2022, të Presidentit, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, nenit 94, 95 dhe nenit 120, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Udhëzuesin e Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO – Kryetare**

**Arens ÇELA – Anëtar**

**Dritan ÇAKA – Anëtar**

**Helga VUKAJ – Anëtare**

**Muharrem ÇAKAJ - Anëtar**



Data: 25 Shkurt 2022

Nr. 23

“Për miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”

**UDHËZUESI I PUNËS PËR KOMISIONET E ZONAVE TË  
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR DHE GRUPET E NUMËRIMIT  
TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR  
NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS, VORË,  
RROGOZHINË DHE LUSHNJË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË  
DATË 6 MARS 2022**

## Tabela e Përmbajtjes

I. Rregulla të etikës .....	1
II. Rregulla në kushtet e pandemisë COVID .....	1
III. Detyra të KZAZ për organizimin e VNV .....	1
IV. Rregulla në vendin e numërimit të votave .....	3
V. Detyra të KZAZ për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave.....	3
1. Veprime paraprake për ngritjen e grupeve të numërimit të votave.....	3
2. Ngritja e grupeve të numërimit të votave.....	4
3. Caktimi i anëtarëve zëvendësues në GNV .....	4
4. Plotësimi i vakancave në GNV .....	5
5. Rregulla për grupet e numërimit të votave.....	5
VI. Detyra të KZAZ për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore. ....	5
1. Veprime paraprake për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore .....	5
2. Marrja në dorëzim të materialeve të votimit.....	6
VII. Detyra të KZAZ për numërimin .....	7
1. Veprime paraprake .....	7
2. Fillimi i numërimit të votave .....	8
VIII. Hapja e kutisë së materialeve të votimit .....	11
1. Rrethanat që çojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit.....	11
2. Veprimet me kutinë e materialeve të votimit.....	11
IX. Transmetimi elektronik i rezultateve paraprake dhe nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkie .....	13
1. Veprime paraprake të KZAZ .....	13
2. Plotësimi i tabelës dhe transmetimi i rezultateve paraprake të zgjedhjeve .....	13
3. Hedhja dhe Transmetimi elektronik i të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV.....	14
X. Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për kryetar bashkie nga KZAZ.....	15
XI. Dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ.....	16
XII. Procesi i votimi dhe i numërimit në bashkinë Vorë .....	16

*Vullneti i popullit është baza e autoritetit të pushteteve publike. Ky vullnet duhet të shprehet me zgjedhje të ndershme, periodike, me votim të barabartë universal dhe të fshehtë ose duke ndjekur një procedurë ekuivalente që garanton lirinë e votës”.*

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

*Integriteti i administratës zgjedhore është një nga faktorët më të rëndësishëm për legjitimitetin e zgjedhjeve. Publiku do ta vlerësojë karakterin legjitim të zgjedhjeve në varësi të integritetit të kësaj administrate. Prandaj, njohja dhe përvetësimi i kuadrit ligjor zgjedhor, profesionalizmi dhe pavarësia në përmbushjen e detyrave, me paanësi dhe në shërbim të interesit publik janë çelësi i suksesit për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

## **I. Rregulla të etikës**

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave zbatojnë parimet për legjitimitet, transparencë, paanshmëri, profesionalizëm në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, duhet të shmangin rrethanat e konfliktit të interesit duke e deklaruar atë. Rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhore, i ngarkojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore me përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit.

Ndershmëria, korrektësia, përkushtimi, etika në komunikim janë tipare të rëndësishme për anëtarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe për anëtarin e Grupit të Numërimit të Votave. Puna korrekte e tyre do të sigurojë që vullneti i zgjedhësit/votuesit të materializohet në numërimin korrekt të çdo vote.

Në ushtrimin e detyrës, anëtarët e KZAZ dhe GNV, edhe pse janë propozime të një partie politike të caktuar, duhet të udhëhiqen nga interesi publik. Ata në ushtrimin e detyrave të tyre nuk duhet t'u japin avantazh asnjë partie politike apo grupi interesi. Ata nuk duhet të shprehin ngjyra partiake, simbole apo shenja dalluese të tyre.

## **II. Rregulla në kushtet e pandemisë COVID**

Anëtarët e KZAZ, anëtarët e GNV, në mjedisin e punës së tyre duhet të përdorin mjetet mbrojtëse për shëndetin, maskë higjienike, dezinfektues dhe të respektojnë rregullat anti Covid si dhe të zbatojnë rregullat e higjenës dhe distancimit fizik në përputhje me rregullat dhe protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## **III. Detyra të KZAZ për organizimin e VNV**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton, me vendim, vendndodhjen e VNV-së të çdo ZAZ-je. VNV-ja vihet në dispozicion të KZAZ, jo më vonë se 10 ditë para zgjedhjeve.

KZAZ, menjëherë, me marrjen në dorëzim të VNV-së, në bashkëpunim me organet e vetëqeverisjes vendore:

- a) siguron dhe sistemon VNV, pajisjet logjistike të nevojshme (tryeza pune me hapësira të mjaftueshme për çdo GNV, tryeza e karrige për KZAZ e personelin teknik apo karrige për anëtarët e GNV, për vëzhguesit), ndriçimin e pandërprerë, për mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave.
- b) merr masa për krijimin e kushteve të përshtatshme, ndjek dhe monitoron procesin e instalimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

KZAZ, jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon dhe përgatit VNV në mënyrë të tillë që të garantohet zhvillimi i qetë, i rregullt dhe në transparencë të plotë i procesit të numërimit të votave.

Vendi i punës së KZAZ është në mjedisin ku kryhet procesi i numërimit të votave dhe ky proces duhet të shihet pa asnjë pengesë nga vetë KZAZ, vëzhguesit, kandidatët apo përfaqësuesit e medias.

KZAZ, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, pasi ka sistemuar e organizuar VNV sipas kritereve si dhe me pajisjet logjistike, fton për njohje të VNV-së subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve.

KZAZ duhet të kujdeset për teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave (kamera regjistruese e monitorë), të instaluar në VNV. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me një kamera dhe monitor. KZAZ-ja kujdeset për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV dhe deri në nxjerrjen e rezultatit të Zonës së Administrimit Zgjedhor. Grupi i Numërimit të Votave është përgjegjës për ekspozimin e çdo flete votimi në kamera. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në mënyrë elektronike dhe dorëzohet në KQZ, së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Ju mund t'i referoheni nenit 94/4 të Kodit Zgjedhor.

Policia organizon ruajtjen e ambientit të Vendit të Numërimit të Votave prej orës 18<sup>00</sup> të ditës së zgjedhjeve deri në momentin e nxjerrjes së tabelës së rezultatit nga KZAZ-ja. Punonjësi i Policisë së Shtetit qëndron jashtë ambienteve të Vendit të Numërimit të Votave, sipas caktimit të bërë nga KZAZ.

Rregulla të detajuara për mënyrën e organizimit të VNV përcaktohen në vendimin nr.3, datë 9.2.2021 të Komisionit Rregullator “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

#### **IV. Rregulla në vendin e numërimit të votave**

KZAZ lejon, në VNV, anëtarët e grupit të numërimit të votave, vëzhguesit e akredituar, përfaqësuesit e akredituar të medias, operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave, personelin teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, stafin e KQZ, të pajisur me autorizim të posaçëm, të cilët duhet të qëndrojnë në vendin e caktuar dhe të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit, sipas funksionit që ata kanë, të lëshuar nga KQZ/KZAZ si dhe të kenë letërnjoftimin/kartën e identitetit ose pasaportën. Dy nga anëtarët e KZAZ, të caktuar prej saj, i verifikojnë këto dokumente.

#### **V. Detyra të KZAZ për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave**

##### **1. Veprime paraprake për ngritjen e grupeve të numërimit të votave**

KZAZ kryen këto veprime paraprake:

- a) cakton me vendim, numrin e grupeve të numërimit të votave, për çdo tavolinë numërimi, vendim që dokumentohet përmes modelit KZAZ 8, të miratuar me vendimin përkatës të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për çdo tavolinë numërimi janë dy grupe të numërimit të votave dhe çdo grup numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi. Në funksion të procesit të numërimit, funksionojnë edhe grupe të dyta të numërimit të votave të cilat angazhohen me vendim të KZAZ, kur grupet e para përfundojnë punën apo e ndërpresin atë për shkaqe të papërligjura. Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta të numërimit nuk futen në punë.
- b) numërton GNV-të me numër rendor rritës. Numri i fundit rendor është gjithmonë një numër çift;
- c) U kërkon, me shkrim, partive politike, të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve, të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve, të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve. Propozimet, për anëtarë të GNV, i paraqiten KZAZ edhe nga degët lokale të partive politike, kur partitë politike ua kanë deleguar të drejtën e propozimit.

## 2. Ngritja e grupeve të numërimit të votave

Çdo grup numërimi përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë si vijon:

- a) Partia Demokratike, në KZAZ 03 dhe 05 në Shkodër; 19 në Dibër; 21 dhe 23 në Durrës, 43 në Rrogozhinë dhe 55 në Lushnjë, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “tek” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “çift” të numërimit të votave.
- b) Partia Socialiste e Shqipërisë, në KZAZ 03 dhe 05 në Shkodër; 19 në Dibër; 21 dhe 23 në Durrës, 43 në Rrogozhinë dhe 55 në Lushnjë, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “çift” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “tek” të numërimit të votave.
- c) Partia Socialiste e Shqipërisë, në KZAZ 02 dhe 04 në Shkodër; në KZAZ 22 dhe 24 në Durrës; 26 në Vorë dhe 54 në Lushnjë ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “tek” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “çift” të numërimit të votave.
- d) Partia Demokratike, në KZAZ 02 dhe 04 në Shkodër; në KZAZ 22 dhe 24 në Durrës; 26 në Vorë dhe 54 në Lushnjë ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “çift” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “tek” të numërimit të votave.
- e) Në çdo KZAZ, Partia Socialiste e Shqipërisë ka të drejtën të propozojë anëtarin e tretë të GNV, ndërsa Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka të drejtën të propozojë anëtarin e katërt të GNV.
- f) KZAZ, jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve, emëron anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, veprim që dokumentohet përmes modelit Tip “Për emërimin e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave”, miratuar me Vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

## 3. Caktimi i anëtarëve zëvendësues në GNV

- a) Në rast se, një parti politike nuk paraqet propozim të paktën 12 ditë nga data e zgjedhjeve, KZAZ me vendim cakton anëtarët zëvendësues. Anëtarët zëvendësues caktohet me short



ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin të njëjtës parti politike në Zonën e Administrimit Zgjedhor. Anëtarët e KQV-ve, të përzgjedhur nga sekretari i KZAZ, renditen, në mënyrë rastësore, në lista, sipas partive politike të cilat i kanë propozuar. Çdo emri të renditur i vendoset një numër rendor rritës duke filluar nga 01. Vendosen shirita letre në një enë transparente, ku janë shënuar numrat rendorë që i korrespondojnë çdo anëtari të KQV-së të partisë politike përkatëse të renditur në listë, të cilat tërhiqen nga kryetari i KZAZ, aq sa është numri i anëtarëve që mungojnë. Anëtari i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike, për të cilën hidhet shorti, të cilit i korrespondon numri rendor i shënuar në shiritin e letrës së tërhequr, caktohet anëtar i Grupit të Numërimit të Votave.

- b) Partitë politike, të cilat kanë të drejtën të paraqesin propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV, dhe nuk kanë anëtarë në KQV, humbasin të drejtën të paraqesin anëtar të GNV, nëse nuk propozojnë anëtarin të paktën 12 ditë nga data e zgjedhjeve.

#### 4. Plotësimi i vakancave në GNV

Në rast se partia politike përkatëse nuk paraqet menjëherë propozimin për plotësimin e vendit të mbetur vakant, GNV vazhdon numërimin, kur anëtarët në detyrë nuk janë më pak se dy.

Procedura për caktimin e anëtarëve zëvendësues në GNV ndiqet edhe për plotësimin e vakancave, kur GNV mbetet me më pak se dy anëtarë.

Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

#### 5. Rregulla për grupet e numërimit të votave

- a. Anëtarët e GNV duhet të numërojnë detyrimisht kutitë e pranuar si të rregullta.
- b. Refuzimi i numërimit të votave çon në shkarkimin e menjëhershëm të personave përgjegjës dhe përbën vepër penale.
- c. Procesi i numërimit vazhdon pandërprerje, deri në numërimin e të gjitha kutive.

### VI. Detyra të KZAZ për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore.

KZAZ mbikqyr, drejton dhe kontrollon procesin e marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ.

#### 1. Veprime paraprake për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore

▪ **Përcaktimi i vendit të vendosjes së kutive dhe të sistemimit të tyre**  
KZAZ cakton paraprakisht vendin ku do të vendosen kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit, para dhe pas numërimit, sipas Planvendosjes Orientuese, si dhe një hapësirë për kutitë e votimit të vlerësuara “kuti e parregullt”. Kutitë me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit vendosen sipas numrit të qendrës së votimit, ndërsa qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës. Në rreshtin e parë, vendoset kutia e votimit me fletët e votimit dhe në rreshtin e dytë vendoset kutia me materialet e votimit. QV-të numri unik i të cilave është me fraksion “bijë”, renditen pas QV-ve të origjinës (mëmë”).

▪ **Ngritja e grupeve për marrjen në dorëzim të materialeve të votimit.**  
KZAZ-ja, pas mbylljes së procesit të votimit, ngre dhe organizon, në VNV, një ose më shumë grupe që marrin menjëherë në dorëzim materialet e votimit të sjella nga KQV-të. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së, të përkatësive të kundërta politike. Nëse është e nevojshme, KZAZ, nga lista e anëtarëve të GNV-ve, cakton dy persona, të përkatësive të kundërta politike, në ndihmë të çdo grupi të marrjes në dorëzim, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së.

Grupet e marrjes në dorëzim, në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutive të votimit, kutive të materialeve të votimit apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore, të cilat vijnë në VNV nga KQV-të, në juridiksionin e KZAZ-së përkatëse.

Pajisjet e teknologjisë (PEI dhe Kamera) merren në dorëzim duke plotësuar kartelat shoqëruese të pajisjeve, për t’jua dhënë menjëherë punonjësve të KQZ-së të autorizuar për tërheqjen e tyre. KZAZ ndjek procedurat specifike sipas aktit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri.

## 2. Marrja në dorëzim të materialeve të votimit

Grupi i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore, pasi merr, nga sekretari i KZAZ, dosjen e KQV përkatëse, në të cilën gjenden procesverbalet e plotësuara Model KZAZ 22, Model KZAZ 23 dhe modeli krahasues i vulës së kryetarit të KQV-së, kryen këto veprime:

▪ **Verifikim**

- a) Verifikon, në çast, përputhjen e numrave të kodeve të vulave të sigurisë, me të cilat janë mbyllur kutia me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me ato të shënuara në procesverbalin Model KZAZ 23.
- b) Verifikon nëse, në kutitë e fletëve të votimit dhe të materialeve zgjedhore, ka hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj, nëse ka thyerje, çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialeve zgjedhore, nëse është e llojit, formës apo përmasave të ndryshme nga ato të miratuara, apo mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie.

#### ▪ Dorëzim

- a) Plotëson procesverbalin Model KZAZ 24, në çdo rubrikë të tij, duke shënuar numrat e kodeve të vulave të sigurisë, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit dhe duke i krahasuar me ato të procesverbalit model KZAZ 23.
- b) Dorëzon, tek anëtarët e KZAZ, materialet e votimit dhe nënshkruan procesverbalin Model KZAZ 24 dhe vepron sipas përcaktimeve në këtë procesverbal. Punonjësi i policisë e nënshkruan procesverbalin vetëm për shoqërimin, garantimin dhe mosprekjen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit nga QV në VNV. Originali i procesverbalit model KZAZ 24 administrohet nga KZAZ dhe dorëzohet detyrimisht në KQZ, në momentin e dorëzimit të materialeve të dokumentacionit zgjedhor.

#### ▪ Konstatim dhe deklaram

- a) I kërkon KZAZ, që kutia në të cilën konstatohet parregullsi nga procesi i verifikimit, të shënohet “Kuti e parregullt”.
- b) Anëtarët e KZAZ, te vendi i dorëzimit të kutive, verifikojnë parregullsinë e konstatuara. Ata marrin vendim, kur vlerësojnë se kutia është e parregullt, dhe vendosin etiketën “kuti e parregullt” dhe e vendosin atë në këndin e kutive të parregullta.
- c) Parregullsitë shënohen nga grupi i marrjes në dorëzim në procesverbalin model KZAZ 24 dhe nga KZAZ, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe Procesverbalin e Konstatimit.
- d) Kutia e përcaktuar si “Kuti e parregullt”, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet nga KZAZ dhe nuk i kalojnë GNV për vlerësim. Kjo kuti, dërgohet në KQZ, së bashku me kutinë e materialeve të votimit për nevoja të hetimit.

## **VII. Detyra të KZAZ për numërimin**

### 1. Veprime paraprake

**KZAZ**, pasi ka marrë në dorëzim bazën materiale të të gjitha QV-ve në juridiksionin e saj, kryen këto veprime:

- a) përcjell informacionin për Qendrat e Votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar (nëse ka) si dhe për kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit të cilat janë vlerësuar “kuti të parregullta”;
- b) sigurohet që anëtarët e GNV janë trajnuar, janë të pranishëm e të ulur në tavolinat përkatëse, të pajisur me mjetet e nevojshme logjistike;
- c) verifikon që personat e pranishëm në VNV janë vetëm personat e autorizuar nga KQZ-ja apo/dhe akredituar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja;
- d) merr konfirmim nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave;
- e) merr vendimin për fillimin e procesit të numërimit të votave, i cili shënohet nga sekretari në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe në Regjistrin e Vendimeve të KZAZ.

## 2. Fillimi i numërimit të votave

- **Marrja e kutisë së votimit nga sekretari i GNV**  
Sekretari i GNV, nën drejtimin e kryetarit apo një anëtar të ngarkuar të KZAZ:
  - a) merr me radhë dhe sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, nga stiva e kutive të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi, dhe e vendos pranë tryezës së GNV përkatëse;
  - b) merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV;
  - c) ngjit në tavolinë etiketën adezive dhe shkruan numrin e qendrës së votimit që numërohet.
- **Hapja e kutisë së votimit**
  - a) Numëruesi i parë vendos mbi tryezë kutinë me fletët e votimit për kryetar bashkie dhe pasi këput vulat me kodet e sigurisë (përveç kodit që mbyll hapësirën e kapakut ku janë hedhur fletët e votimit), e hap atë duke ekspozuar në ekran, për jo më pak se 2 sekonda, faqen anësore ku është vendosur etiketa me numrin e qendrës së votimit.
  - b) Anëtarët e GNV nxjerrin nga kutia me fletët e votimit, Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, Model KQV 8 dhe Raportin e Mbylljes së Identifikimit Elektronik të zgjedhësve, i printuar

nga PEI si dhe verifikojnë nëse procesverbali i Mbylljes së Votimit është plotësuar saktë. Nëse ky procesverbal është plotësuar saktë, GNV fillon procedurat për numërimin e votave dhe vlerësimin e fletëve të votimit.

#### ▪ Numërimi i fletëve të votimit

Numëruesi i parë dhe anëtarët e GNV hapin, në mënyrë të plotë, çdo fletë votimi, në anën e pasme të saj, nga ana e sipërme, për të verifikuar praninë e vulave në fletën e votimit.

Numëruesi i parë numëron fletët e votimit dhe e deklaron shifrën për anëtarët e GNV dhe për vëzhguesit si dhe verifikon shifrën e deklaruar me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në procesverbalin model KQV 08 dhe me Raportin e Mbylljes së Identifikimit Elektronik, nëpërmjet PEI. Nëse shifra nuk përputhet, GNV i referohet shifrës të Raportit të Mbylljes së Identifikimit Elektronik PEI, përveç rasteve kur procedura e votimit është zhvilluar edhe në mungesë të PEI.

Numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit, nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të GNV.

Kur konstatohen mospërputhje, GNV ose vëzhgues të subjekteve zgjedhore, pa lëvizuar nga vendi dhe duke ngritur dorën, njofton KZAZ. Derisa KZAZ të verifikojë rastin, procesi mbetet i pezulluar dhe GNV nuk kryen veprime të mëtejshme.

Sekretari i KZAZ pasqyron pasaktësinë në Procesverbalin e Konstatimit vetëm pasi KZAZ ka konfirmuar atë. KZAZ merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga GNV-ja dhe ky vendimi i njoftohet GNV.

#### ▪ Vlerësimi i fletëve të votimit

Vlerësimi i vlefshmërisë së votave ka si synim të identifikojë qëllimin e votuesit.

GNV-ja, përcakton në tavolinën e numërimit, vende të veçanta për fletët e votimit të vlefshme, të pavlefshme apo të kontestuara si dhe për fletët e votimit të vlefshme për çdo kandidat për kryetar bashkie.

Numëruesi i parë i vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, fillimisht nga faqja e pasme, jo më pak se 3 sekonda, në mënyrë që të shihen qartë në monitor vula e KQV-së dhe Vula e Kryetarit të KQV-së. Njëkohësisht, numëruesi i parë, gjatë këtij procesi, verifikon nëse fleta e votimit ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë, me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja, është vulosur me vulën e KQV-së dhe me vulën e Kryetarit të KQV-së apo ka shënime, shenja apo nënshkrime, që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit. Gjatë këtij verifikimi,

numëruesi i parë, shprehet me zë të lartë vetëm për fletët e votimit, të cilat i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme.

Në rast se ndonjë nga anëtarët e GNV ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nuk është dakort me vlerësimin e mësipërm, numëruesi i parë e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara (e cila do të vlerësohet përsëri nga GNV në momentin e rivlerësimit të votave) dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

Në rast se gjatë kryerjes së kësaj procedure, për fletën e votimit, vlerësuar e pavlefshme, nuk ka patur kontestime, atëherë ajo vendoset në vendin e caktuar për votat e pavlefshme mbi tavolinën e punës së GNV-së.

#### ▪ Vlerësimi i votave

Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas vlerësimit të fletës së votimit nga faqja e pasme.

Numëruesi i parë, kur vlerëson se vota identifikon qëllimin e votuesit dhe se është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie/ subjekt zgjedhor dhe nuk është në rrethanat e pavlefshmërisë sipas nenit 117 të Kodit Zgjedhor, e tregon atë tek anëtarët e tjerë të GNV si dhe e vendos fletën e votimit në kamerën regjistruese, jo më pak se 4 sekonda, në mënyrë që vota të shikohet qartësisht në monitor dhe deklaron me zë të lartë, emrin e kandidatit për kryetar bashkie për të cilin është dhënë vota. Fleta e votimit vendoset në vendin e caktuar për partinë politike, koalicionin apo kandidatin e propozuar nga zgjedhësit.

Votat e pavlefshme vendosen në vendin e caktuar për votat e pavlefshme.

#### ▪ Kontestimi dhe rivlerësimi i votës

Kontestimi i votës bëhet nga anëtarët e GNV ose çdo vëzhgues i subjekteve zgjedhore duke ngritur dorën e duke thënë “Nuk jam dakord”.

Numëruesi i parë, e vendos fletën e votimit të kontestuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit. Në përfundim të vlerësimit të fletëve të votimit të kutisë përkatëse të votimit, GNV rivlerëson fletët e votimit të kontestuara, por gjatë këtij procesi, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, fleta e votimit nuk shfaqet më në kamera. Në çdo rast, vëzhguesit informohen për përfundimin e rivlerësimit. Në rast se mbeten ende fletë votimi të kontestuara, edhe pas rivlerësimit, secili anëtar i GNV thërret KZAZ-në për vlerësimin e fletëve të votimit të kontestuara të asaj kutie. Vlerësimi i votës bëhet menjëherë nga KZAZ e cila merr vendimin për votë të vlefshme ose të pavlefshme. Sekretari i KZAZ shënon rezultatin

e shpallur, nga KZAZ, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve i cili përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton Grupi i Numërimit të Votave.

- **Numërimi i votave të çdo kandidati për kryetar bashkie**

Pas numërimit dhe vlerësimit të votave për çdo kuti votimi, numëruesi i parë numëron votat për çdo kandidat për kryetar bashkie. Pas çdo numërimi, shifrën ia bën të ditur anëtarëve të GNV dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Në rast se kërkohet nga ndonjë anëtar i Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e votave për atë kandidat.

Në rast se, edhe pas këtij numërimi të dytë ka përsëri kundërshtime, numëruesi i parë ose anëtari kundërshtues, njofton KZAZ, nëpërmjet ngritjes së dorës. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV, deri në marrjen e vendimit nga KZAZ. KZAZ numëron në vend votat për kandidatin, objekt kundërshtimi, dhe urdhëron GNV të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi.

## **VIII. Hapja e kutisë së materialeve të votimit**

### **1. Rrethanat që çojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit**

Nëse në kutinë e votimit, Procesverbali i Mbylljes së Votimit model KQV 8 mungon ose nuk është plotësuar saktë, apo kur në kutinë e votimit mungon Raporti i Mbylljes së Identifikimit Elektronik të zgjedhësve, i printuar nga PEI (kur procedura është zhvilluar me pajisjen elektronike PEI), anëtari i GNV apo vëzhguesi, pa lëvizur nga vendi, njofton menjëherë KZAZ-në për problemin, duke ngritur dorën. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV. Në rast se KZAZ konfirmon pasaktësinë ose parregullsinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit dhe vetëm pas regjistrimit të këtyre fakteve, KZAZ merr vendim për pezullim të numërimit të votave dhe vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit/zgjedhor. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë GNV.

### **2. Veprimet me kutinë e materialeve të votimit**

Kur është marrë vendimi i pezullimit, numëruesi i parë, në tavolinën e numërimit fillon veprimet me kutinë e materialeve të votimit të asaj qendre votimi, duke këputur vulat me kodet e sigurisë të saj.

GNV, si fillim, verifikon nëse në kutinë e materialeve të votimit ndodhet Procesverbali për Mbylljen e Votimit, Model KQV 8, i plotësuar në mënyrë të rregullt si dhe nëse ndodhet kopja

e Raportit të Mbylljes së Identifikimit Elektronik të zgjedhësve, i printuar nga PEI, i nënshkruar dhe vulosur nga gjithë anëtarët e KQV-së. Nëse këto gjenden, GNV i dorëzon tek KZAZ, e cila i fotokopjon, i administron si dhe i pasqyron këto fakte në Procesverbalin e Konstatimit, ndërsa origjinali vendoset sërish, nga GNV, në kutinë e materialeve të votimit.

KZAZ pajis GNV me vulat me kodet e sigurisë për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, të cilat shënohen, nga sekretari i GNV, në procesverbalin Model GNV 2. Ky procesverbal futet në kutinë e materialeve të votimit dhe kutia mbyllet me vulat me kode sigurie.

Nëse dokumentacioni i sipërcituar nuk ndodhet, GNV ka për detyrë të verifikojë zarfin e identifikimit biometrik, zarfin me fletët e votimit të papërdorura apo zarfin me fletë votimi të dëmtuara, listën e zgjedhësve, vulat, përkatësisht të KQV dhe të kryetarit të KQV, vulat me kodet e sigurisë të papërdorura, nëse ka, vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara, Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe origjinalet e vendimeve të marra nga KQV.

Numëruesi i parë është ai që numëron fletët e votimit të papërdorura, të dëmtuara, nënshkrimet e zgjedhësve në listën e votuesve, përfshirë edhe ata në regjistrin e posaçëm kur procesi i votimit është zhvilluar pa pajisjen PEI, apo edhe kur procesi i votimit është zhvilluar pjesërisht me pajisjen PEI dhe bën të ditura shifrat përkatëse për anëtarët e GNV apo vëzhguesit. Në rast të pasaktësive apo kur kërkohet rinumërim nga anëtarët e GNV apo vëzhguesit, është i detyruar të rifillojë rinumërimin. Vërejtjet shënohen në Procesverbalin e Konstatimit, nga KZAZ-ja, pas njoftimit nga GNV. Edhe kur procesi i votimit është realizuar plotësisht me përdorimin e pajisjes PEI, numëruesi i parë jep numrin e zgjedhësve që kanë votuar sipas Raportit të Mbylljes së Identifikimit Elektronik, të printuar nga PEI, të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së dhe të vulosur. Gjithashtu, ai krahason vulën e Kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ua bën të ditur anëtarëve të GNV. Numëruesi i parë hedh të dhënat në tabelën e rezultateve të qendrës së votimit, numrin e fletëve të votimit sipas dokumentacioni shoqërues si dhe të dhënat mbi numrin e zgjedhësve që kanë votuar, numrin e fletëve të votimit të përdorura e të dëmtuara si dhe shënon numrat e kodeve në procesverbalin e mbylljes së kutisë së materialeve të votimit, i cili futet në këtë kuti.

Numëruesi i parë, pasi vendos kutinë e materialeve të votimit pranë tavolinës së numërimit, merr kutinë e fletëve të votimit, numërimi i së cilës ishte pezulluar, vijon me numërimin e votave, sipas procedurave të thëna më sipër.



## **IX. Transmetimi elektronik i rezultateve paraprake dhe nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkie**

### **1. Veprime paraprake të KZAZ**

KZAZ-ja, i jep sekretarit të GNV:

- a) Tabelën e Rezultateve për Qendrën e Votimit Model KZAZ 30, format A4, në të cilën janë paraprintuar kandidatët për kryetar bashkie siç janë në fletën e votimit.
- b) Vulat me kodet e sigurisë, të cilat shërbejnë për mbylljen e kutisë së votimit;
- c) Procesverbalin e GNV-së për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara, MODEL GNV 1.
- d) Zarfat e emërtuar:
  - i. Zarf i fletëve të votimit të vlefshme, Z.06;
  - ii. Zarf i fletëve të votimit të kontestuara, Z.04;
  - iii. Zarf i fletëve të votimit të pavlefshme, Z.05.

### **2. Plotësimi i tabelës dhe transmetimi i rezultateve paraprake të zgjedhjeve**

GNV, para plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së përkatëse, kontrollon dhe sigurohet për kushtet që përdor aplikacioni kompjuterik.

#### **▪ Kushtet e aplikacionit kompjuterik të zbatohen si më poshtë:**

- a) Numri i zgjedhësve që kanë votuar (sipas shifrës shënuar në PV Model KQV 8 ose raportin e mbylljes së identifikimit elektronik), duhet të jetë jo më i madh se numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve të asaj QV-je;
- b) Numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
  - ❖ Në rast se çënohen kushtet e aplikacionit kompjuterik shkronja a) dhe b), më sipër, dhe pas verifikimeve që bën sekretari i KZAZ-së rezulton se mospërputhja vjen nga ndonjë gabim njerëzor i bërë në VNV, lejohet korrigjimi në sistem i shifrave;
  - ❖ Në rast se çënohen kushtet e aplikacionit kompjuterik shkronja a) dhe b), më sipër, dhe pas verifikimeve që bën KZAZ-ja rezulton se mospërputhja nuk vjen si pasojë e gabimeve njerëzore, por pasqyron të dhënat që janë në Procesverbalin e Mbylljes së

*Votimit Model KQV 08/ Raportit të Mbylljes së Identifikimit Elektronik, aplikacioni kompjuterik lejon vazhdimin e procesit duke bërë në sistem shënimin “mospërputhje”.*

- c) Numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme me votat e pavlefshme, kur ka të tilla;
  - d) Numri i votave të vlefshme të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara për kandidatët për kryetar bashkie.
- ❖ *Në rast se çënohen kushtet e aplikacionit kompjuterik shkronja c) dhe shkronja d) bëhet kontrolli për gjetjen e gabimit dhe bëhen korrigjimet përkatëse, pasi aplikacioni kompjuterik nuk lejon për asnjë arsye cënimet e këtyre rregullave.*

Numëruesi i Parë, së bashku me anëtarët e tjerë të GNV-së, plotëson Tabelën e Rezultateve për Qendrën e Votimit, Model KZAZ 30, në të gjitha rubrikat e saj. Kjo tabelë e plotësuar me shkrim dore dhe e firmosur nga anëtarët e GNV vendoset ndënë kamera dhe shfaqet në monitor për jo më pak se 4 sekonda. Nëse ndonjë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore ka kundërshtime në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë, ato shënohen në Librin e Protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nga sekretari i saj.

Numëruesi i parë, menjëherë pas shfaqjes në monitor, dorëzon dorazi te sekretari i KZAZ, Tabelën e Rezultateve për QV-në, për kandidatët për kryetar bashkie.

Pas plotësimit të Tabelës së Rezultateve të çdo QV-je, KZAZ-ja dërgon elektronikisht, nëpërmjet sistemit në KQZ, informacionin për rezultatin e zgjedhjeve të asaj QV-je.

### 3. Hedhja dhe Transmetimi elektronik i të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV

Sekretari i KZAZ-së, Tabelën e Rezultateve për Qendrën e Votimit, ia jep atë operatorit të hedhjes së të dhënave i cili vepron si më poshtë:

- a) Operatori i hedh këto të dhëna në aplikacionin elektronik në kompjuter dhe printon në letër, në 5 kopje, informacionin që ka në formë elektronike. Menjëherë pas printimit aplikacioni elektronik automatikisht bëhet i pa editueshëm/i pa shkrueshëm.
- b) Tabelat e printuara nga forma elektronike i dorëzohen GNV nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar saktësinë e të dhënave.
  - i. Në rast se informacioni i dhënë me shkrim dore nga GNV dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, pasi firmosen tabelat e printuara nga anëtarët e GNV sekretari i

KZAZ-së fut në sistem kodin personal të tij dhe udhëzon operatorin të dërgojë, në rrugë elektronike, rezultatet në KQZ.

- ii. Në rast se informacioni i dhënë me shkrim dore nga GNV dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshëm, numëruesi i parë i GNV bën korrigjimet me shkrim dore në fletën e printuar me gabime dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GNV.

Sekretari i KZAZ fut në sistem kodin e tij duke e kthyer aplikacionin elektronik në të editueshëm/të shkrueshëm dhe udhëzon operatorin të bëjë korrigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe më pas, kur është arritur saktësia, dërgimit në KQZ.

- c) Tabela e rezultateve për QV-në, e printuar në 5 kopje dhe e firmosur nga anëtarët e GNV, pas verifikimit të saktësisë, u jepet, kopja e parë KZAZ-së, të tjerat, anëtarëve të GNV. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit e numërimit të votave për të gjitha QV-të dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GNV te KZAZ-ja.
- d) Tabela e Rezultateve për QV-në e printuar dhe e firmosur nga GNV dhe tabela e rezultateve e plotësuar me shkrim dore nga GNV, i bashkëngjiten njëra-tjetrës, shërbejnë si dokumentacion zyrtar dhe dorëzohen dorazi nga KZAZ-ja në KQZ, së bashku me Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në.
- e) Pas transmetimit të tabelës së rezultateve të çdo QV-je në KQZ, kopje të tabelave të rezultateve Model KZAZ 30 (fotokopjohen në makinën printer/fotokopje/skaner, që ndodhet në VNV), të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.
- f) Nëse ndonjë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore ka kundërshtime në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë, ato shënohen menjëherë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, nga Sekretari i saj [KZ, neni 119/2].

## **X. Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për kryetar bashkie nga KZAZ**

Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve dhe hedhjes e transmetimit elektronik të rezultateve në KQZ, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për kryetar bashkie për ZAZ-në, Modelit KZAZ 32.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të ZAZ-së, e printuar, kontrollohet nga anëtarët dhe miratohet me vendim nga KZAZ-ja, Model KZAZ 34, për bashkitë territori i të cilave mbulohet nga një ZAZ, dhe Model 34-1 për bashkitë territori i të cilave mbulohet nga më shumë se një ZAZ.

Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së dhe vendimin për miratimin e saj të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

*Kujdes! Në raste të jashtëzakonshme nëse nuk mund të printohet Tabela Përmbledhëse e Rezultateve nga baza elektronike e të dhënave, atëherë sekretari i KZAZ-së plotëson me dorë Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së Model KZAZ 32. Këto tabela përmbledhëse, dërguar nga KQZ me bazën materiale, janë të paraprintuara me kandidatët sipas përmbajtjes së fletës së votimit.*

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së dërgojnë çështjen për shqyrtim në KQZ.

## **XI. Dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ**




KZAZ është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të zgjedhjeve, materialeve zgjedhore. Menjëherë pas nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve në ZAZ, Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i KZAZ dorëzojnë, me procesverbal, në KQZ, dokumentacionin e Zgjedhjeve e materialet zgjedhore, si dhe regjistrimin filmik të procesit të regjistrimit për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre dhe vlerësimit të çdo flete votimi, i cili ruhet në mënyrë elektronike. Asnjë procesverbal i KZAZ-së nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.




Në rast se nuk do të dorëzohen të gjitha materialet e inventarizuara, vlera financiare e tyre do të mbahet nga pagesa e anëtarëve të KZAZ-së.


## **XII. Procesi i numërimit në bashkinë Vorë**


Në Qendrat e votimit të KZAZ 26, të bashkisë Vorë, procesi i votimit do të kryhet përmes pajisjes elektronike të votimit dhe procesi i numërimit do të kryhet përmes pajisjes elektronike të numërimit (PEVN). Procesi i nxjerrjes së rezultateve për çdo QV dhe në rang bashkie realizohet nga KZAZ. KZAZ kryen procesin e numërimit të votave në Sistemin Elektronik Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR). Në rastin kur procedura e votimit është zhvilluar në njëren pjesë të ditës manualisht, KZAZ aktivizon GNV-të të ndjekin procedurat standarde për numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve sipas udhëzimeve të KQZsë, vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike. Detaje për zhvillimin e zgjedhjeve të bashkinë Vorë janë përcaktuar në vendimin nr. 18, datë 15 Shkurt 2022 të Komisionit Rregullator.


Vota të pavlefshme

	REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	
VOTË E PAVLEFSHME		<b>FLETË VOTIMI</b> Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022
<b>Bashkia Shkodër</b>		
Zgjidh kandidatin		
1	<input type="text"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="text"/>
3	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>

	REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	
VOTË E PAVLEFSHME		<b>FLETË VOTIMI</b> Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022
<b>Bashkia Vorë</b>		
Zgjidh kandidatin		
1	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>
		<input checked="" type="checkbox"/>
2	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>
3	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



**FLETË VOTIMI**  
 Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022





**Bashkia Durrës**

Zgjidh kandidatin

1		
2		
3		


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE


**FLETË VOTIMI**  
 Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022



**Bashkia Lushnjë**

Zgjidh kandidatin

1		
2		
3		


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE


**FLETË VOTIMI**  
 Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022



**Bashkia Rrogozhinë**

Zgjidh kandidatin

1		
2		
3		


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE


**FLETË VOTIMI**  
 Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022









**Bashkia Vorë**

Zgjidh kandidatin

1		X
2		X
3		X

Vota të vlefshme

 VOTË E VLEFSHME		<b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b> KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	
<b>FLETË VOTIMI</b> Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022			
<b>Bashkia Shkodër</b>			
<b>Zgjidh kandidatin</b>			
1	<input type="text"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
2	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>	
3	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>	

 VOTË E VLEFSHME		<b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b> KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	
<b>FLETË VOTIMI</b> Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022			
<b>Bashkia Rrogozhinë</b>			
<b>Zgjidh kandidatin</b>			
1	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>	
2	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>	
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/>	